

## P A N E L

### ME RASTIN E DITLINDJES SE PEJGAMBERIT A.S.

**“Muhamedi nuk është babë i askujt prej njerëzve tuaj, por është Pejgamber i Perendisë dhe vula e Pejgamberëve, e Perendia është i Gjithdijshtëm për çdo gjë.” (Ahzab, 40)**

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

*“Unë në krahasim me pejgamberët tjerë që kanë qenë para meje jam sikur një njeri i cili ka ndërtuar shtëpinë në mënyrë të përsosur në përjashtim të një tullës e cila në një skaj i mungon. Njerëzit që e vizitojnë shtëpinë e shohin këtë mungesë dhe thonë sikur të mos i mungonte kjo tullë!? Unë jam ajo tull. Unë jamë vula e pejgamberëve.”*

Muslimanët e botës festojnë ditëlindjen e Pejgamberit të fundit, vulës së pejgamberëve, Muhammedit s.a.v.s. Për dallim nga vitet e tjera ditëlindjen e sivjetshme muslimanët e festojnë më krenarë sepse, në mënyrë shumë të denjë dolën në mbrojtje të dinjitetit dhe të personalitetit të Pejgamberit s.a.v.s. ndaj të cilit, të pandërgjegjshmit e kohës u lëshuan për t’ia merrur apo për t’i mohuar dërgatën hyjnore – pejgamberllëkun.

Pra, ne sot jemi tubuar që ta përkujtojmë lindjen e dritës së gjithësisë, nurin e të dy botërave, themelusin e shtetit të parë islam në rruzullin tokësor, burrshtetasin më të devotshëm të të gjitha kohërave, babain më të mirë i cili u bë shembull i përhershëm se si duhet të sillet prindi ndaj femisë, burrin i cili, i frymëzuar nga All-llahu xh. sh. diti se si të sillet ndaj gruas – ndaj bashkëshortes; po e përkujtojmë shokun i cili në mënyrën më të përkryer na tregoi se si duhet të sillet shoku ndaj shokut; pedagogun të përsosur i cili na mësoi se si të edukojmë brezat e reja dhe si të sillemi me të moshuarit. Pa dyshim, po e përkujtojmë më të ndershmin e njerëzimit i cili,

në mënyrë praktike na e mësoi moralin më të lartë për ç'gjë All-llahu xh. sh. thotë: **“dhe, me të vërtetë, ti je me virtyte më të mëdha”** (El-Kalem, 5)

Të përkujtojmë kohën kur Pejgamberi s.a.v.s. veproi! Fiset arabe ishin të hasmuara mes veti. Në shoqërinë e tyre sundonte vetëm ajo që ishte e pamoralshme. I pamoralshëm ishte edhe besimi i tyre sepse ata besonin në politeizëm. Kishin humbur rrugën të cilën All-llahu xh. sh. ua tregoi përmes dërgatave të pejgamberëve të mëparshëm. Raportet shoqërore ishin të ngritura në baza të interesit. U mungonte gati gjithçka që ishte e natyrës së njeriut. Mjafton vetëm të përmendim faktin se fëmijët femra i varrosnin të gjalla. Sepse për ta lindja e femrës në familje ishte lindja e turpit, dhe, pikërisht për këtë atë e varrosnin të gjallë – të posalindur: **“dhe kur shpirtërat bashkohen me trupëra. Dhe kur vajza e varrosur për së gjalli, do të pyetet. Për çfarë faji është mbytur.”** (Et-Tekvir, 8-10)

Fqinj të Gadishullit Arabik nuk ishin në gjendje më të mirë! Për rreth tyre botën e sundonin dy mbretëritë e atëhershme: persiane dhe romake. Edhe persianët kishin humbur besimin e drejtë, ata besonin në bestytini dhe jepeshin në konflikte e kundërthënie të koncepteve të atëhershme filozofike. Feja e tyre ishte zerdutishtja sipas së cilës, martesë më e preferueshme ishte martesë e burrit me nënën, me motrën apo edhe me vajzën. Jezduxhiri II i cili jetoi në gjysmën e dytë të shekullit të pestë u martua me vajzën e vet.

Romakët jetonin me shpirtin e kolonializmit dhe kështu ata humbën rrugën e drejtë. Në mesin e tyre sundonte amoraliteti i paparë.

Në këto kushte dhe rrethana shoqërore-politike All-llahu xh. sh. Dërgoi pejgamberin e fundit, Muhammedin a.s. i cili fillimisht e pati shumë të vështirë të luftonte dukuritë negative shoqërore në mjedisin e fiseve arabe që jetonin në Gadishullin Arabik. Por s'do mend se, me mbështetjen e plotë nga All-llahu xh. sh., me punën e tij të zellshme dhe me shtrirjen e ndihmës së palodhshme të besimtarëve, ai brenda njëzet e tri viteve themeloi shtetin e ri i

cili jo vetëm për atë kohë por edhe për sot, është unikat në themelim dhe në veprim.

Pra, sikur të krahasojmë vlerat morale dhe shoqërore të asaj kohe me kohën në të cilën jetojmë, pa dyshim që do të shohim dallime dhe, këto dallime, për mendimin tim janë shumë të vogël, sepse sot, një numër i caktuar i njerëzve besojnë në atë që iu shpall Muhammedit a.s. ndonëse ky besim, fatkeqësisht ka mbetur në nivelin teorik. Një numër tjetër ka ruajtur besimin e shëndoshë në teori dhe në praktik. Pra, jeton dhe vepron si musliman. Ndërkaq për fat të keq, pjesën dërmuese të botës e ka kapluar dashuria e madhe e jetës dhe drejt këtij synimi qenia njeri ec mjerisht verbërisht. Masa e quajtur **vlerë** për këtë njeri nuk ekziston. Pra, sot kur njeriu e ka të vështirë të mbrojë vlerat morale dhe shoqërore kujtoj se shumë pakë është larg gjendjes së botës kur lindi dhe veproi Pejgamberi s.a.v.s.

Sot kur ne përkujtojmë lindjen e nurit të botës, para së gjithash, me tërë qenien tonë duhet t'iu kthehemi vlerave të cilat na i komunikoi ai brenda 23 viteve, vlerat të cilat All-llahu xh. sh. na i la amanet në Kur'anin famëlartë, vlera të cilat i pranoi për amanet vetëm njeriu-besimtari i përkushtuar. Sot kur në mesin tonë nuk e kemi të dashurin tonë, Muhammedin a.s., kemi në duartë tona Kur'anin dhe Sunnetin dhe, pa dyshim, të gjithë e dijmë pas tij pejgamber tjetër nuk ka, pas Kur'ani Kerimit shpallje tjetër nuk ka. Nuk duhet të harrojmë se, përkujtimii ynë më i mirë për të Dërguarin e All-llahut xh. sh. do të ishte plotësimi i detyrave tona ndaj fesë, ndaj All-llahut dhe ndaj Pejgamberit. Shih për këtë Muhammedi a.s. përmes Fjalës së All-llahu xh. sh. Na thotë: **“Dhe qe, kjo është rruga ime e drejtë; prandaj ndiqnie, e mos shkoni rrugëve tjera që t'ju shmangin ato nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për tu ruajtur nga të këqijat.”** (El-En'am, 153) kurse Pejgamberi s.a.v.s. na porositë: “pas meje ju kam lënë dy sende po qe se kapeni për to asnjëherë nuk do të humbasni. Librin e All-llahut dhe Sunnetin tim”

Dhe krejtë në fund, duke dashur që këto fjalë të lidhin zemrën me zemër, me të vetmin qëllim që vërtet t'i kthehemi vlerave tona fetare shumë të larta, me qëllim që të japim kontributin tonë për të përmirësuar gjendjen tonë, mjedeisin dhe shoqërinë në të cilën jetojmë, le t'i qasemi përkujtimit të datave tona fetare, pra edhe ditëlindjes së të dashurit tonë, Muhammedit a.s. duke e lutur All-llahun xh.sh. që të na largojë nga e keqja dhe të na bëjë prej besimtarëve më të devotshëm, prej atyre besimtarëve për të cilat Pejgamberi ynë kishte respekt të veçantë.

Besimtarë të dashur, më lejoni që në emër të Rijasetit të BFI-së dhe në emrin tim personal t'ju urojë këtë festë të lavdishme duke Ju dëshiruar çdo të mira në këtë jetë dhe në Ahiret.

Bahri Aliu

Zv Reisul Ulema i BFI në RM